Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-353/01-156354/25
Dt. 10.09.2026
P r i z r e n

DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR KK – PRIZREN, me kërkesën **Jak Kaçinari** me banim në rrugën "Saraji" e në bazë të neneve 3 alineja 1 pikat 1.1, 1.6, 1.7, 1.11, 1.17, 1.24 dhe të nenit 4 alineja 1 pika 1.2, e lidhur me nenin 5 alineja 1 pika 1.3 dhe 1.4 si dhe nenit 14 alineja 1 pika 1.4 dhe 1.5 si dhe ne lidhje me nenin 15 pika 1.1 dhe nenit 19 pika 2 të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe në harmoni me dipozitat e nenit 3 alinea1 pikat 1.1, 1.3, 1.5, 1.6, 1.7 dhe 1.8 e lidhur me nenet 4, 5, 9 dhe 11 të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr. 04/L-066, nenit 2 paragrafi2.2,2.10,2.16,2.19 dhe 2.20,nenit3,4 dhe nenit6 të Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturore ,si dhe Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e Parë e Mbrojtjes nr. 01/011 - 604 të dt. 18.12. 2008, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 21,22,44,46,47,48 e lidhur me nenin 86 dhe nenin 125 dhe 127 të LPPA-së , lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I. **LEJOHET: Jak Kacinari** në zhvillimin e punimeve **Renovimin e objektit ekzistues – Lokal afarist rrugën "Sheshi i Shadërvanit" nr.28** e locuar në ngastrën kadastrale nr. **P-71813068-03180-0** Z.K.Prizren me këto kushte:

- Masat të zbatueshme për ndërtesën në fjalë janë të renovimit,përforcimit strukturor dhe konservimit,gjithmonë duke u bazuar dhe duke u përmbajtur parimeve,standardeve dhe teknikave tradicionale për ruajtjen e trashëgimisë kulturore
- Lejohen renovimet sipas projektit të paraqitur,me kusht që ndërhyrjet në ndërtesë nuk do të ndryshojnë pamjet e jashtme të ndërtesës ekzistuese dhe nivelin e majës së kulmit
- Vitrina/Korniza e dritares duhet të punohet nga druri,ku parapeti duhet të jetë min.40-60cm.Materiali i vitrinës së lokalit duhet të jetë nga druri natyror,me nuanca të ngjyrës kafe;
- Proporcionet e kornizës së vitrinave duhet të bazohen dhe të respektojnë modulet tradicionale dhe karakteristike të zonës historike të qytetit
- Decidivisht ndalohet përdorimi dhe mveshja e fasadës së objektit ekzistues me pllaka (qeramike,terakotës etj),pllaka të lustruara guri,llaq sintetike,alumin,plastik,xham reflektues,xham i ngjyrosur e materiale që nuk përdoren apo e imitojnë arkitekturën dhe materiale tradicionale;
- Fasada të ngjyroset me ngjyra tradicionale,të caktuara sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit,si p.sh. ngjyra okër (Investitori duhet të konsultohet paraprakisht me QRTK-Prizren për përcaktimin e nuancës së fasadës).
- Mbulesa e kulmit duhet të jetë me tjegulla tradicionaletë luguara.Nuk lejohet ndryshimi dhe tjetërsimi i vëllimit ekzistues(në lartësi dhe pjerrtësi) të konstrukcionit dhe mbulesës së kulmit.

II. Gjatë renovimit nuk lejohet ndryshimi i gabaritit,lartësisë dhe etazhitetit aktual të ndërtesës

III. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë - Projekti i punuar nga ana e Byros Projektuese **"DIARKO" SH.P.K.**

IV. Investitori decidivisht duhet të përmbahet Rekomandimeve të Vendimit të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore me nr.01-2 të datës 14.01.2026 dhe Rekomandimit të Këshillit për Trashëgimi Kulturore të datës 09.09.2026.

V. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspekcionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.dhe të njoftojë QRTK-Prizren 7 ditë para fillimit të punimeve

VI. Punimet duhet të realizohen nën asistimin dhe mbikëqyrjen periodike nga përfaqësues të QRTK-së-Prizren

VI. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

A r s y e t i m

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se:

Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorëve profesional, të Komunës së Prizrenit.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve të KK Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet investitorit **Jak Kacinari** , për dhënien e lejes për – **Renovimin e objektit ekzistues – lokal afarist në rrugën "Sheshi i Shadërvanit" nr.28** e locuar në ngastrat kadastrale nr. **P-71813068-03180-0** Z.K.Prizren

Nga se u tha më lartë u murr aktvendimi si në dispozitiv.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës MMPH-së në Prishtinë, përmes këtij organi.

Bashkëpunëtor profesional:

Xhejlane Gjini, inxhi. dip. ark.

Drejtori:

Florent Ukaj ecc.dipl.